



KRYEMINISTRI I KOSOVËS, ALBIN KURTI, KA MBAJTUR KONFERENCË PËR MEDIE PËR SHTRENJTIMIN E ÇMIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE

IFAQE 4-5

KURTI FAJËSON QEVERITË E KALUAR PËR SHTRENJTIMIN E ENERGJISË ELEKTRIKE



Kryeministri i Kosovës, Albin Kurti, ka fajësuar qeveritë e kaluar për shtrenjtimin e energjisë elektrike. Në një konferencë për medie ai ka thënë se edhe pas dy dekadave Kosova nuk ka shtuar kapacitetet e prodhimit në KEK. Sipas tij, qeveritë e kaluar kanë investuar mbi një miliard euro në KEK, ndërsa gjendja ka mbetur ashtu siç ishte pasluftës. Ish-kryeministri Abdullah Hoti, as Ramush Haradinaj, nuk janë pajtuar me pretendimet e kryeministrit aktual. Ata e kanë fajësuar Kurtin për mungesë të vizionit në këtë drejtim. Sipas tyre, shtrenjtimi i rrymës është i papërbalueshëm për qytetarët

AKTUALE



MACRONI KONFIRMON PERSPEKTIVËN PËR ANËTARËSIM TË BALLKANIT PERËNDIMOR

F. 2

IKD-ja E VLERËSON TË MANGËT PROJEKTLIGJIN PËR KONFISKIM TË PASURISË

F. 7

PARALAJMËROHET VIZITA E LAJÇAKUT DHE E ESCOBARIT NË PRISHTINË DHE BEOGRAD

F. 3

EKONOMI



KURTI VIZITON AKP-në, PREMTON PËRKRAHJE PËR KËTË INSTITUCION

F. 8

MURTEZAJ: ATK-ja PËR 22 VJET KA INKASUAR RRETH 8 MILIARDË EURO TATIME

F. 8

SPORT



PLLANA, TE PRISHTINA: KJO FANELLË KA PESHË TË MADHE

F. 10

Kryetarët e komunave kërkojnë zgjidhje urgjente për zbatimin e kontratës kolektive

IFAQE 7



RRITJE E MADHE E RASTEVE ME COVID NË KOSOVË, PËR 24 ORË MBI 2 000 RASTE

IFAQE 3

RENOVA
PUTZ
Magedoni
Xhepçisht - Tetovë
Gurëz-Ferizaj
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 735
Fax: +389 44 487 200
Mob: +377 44 501 289
E-mail: renova@mt.net.mk

PRINCESHA
GROUP SH.P.K.
NDËRTIM
PROJEKTIM
SHITJE
INFO: 049-111-101,
044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
MITROVICË
044/256-051
044/367-061
028/532-617
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

Kolegji BIZNESI
www.kolegjbiznesi.com
info@kolegjbiznesi.com
038 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A
DEGA KOSOVË
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë,
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

INFINITY
Digital Agency
Endrit Shaqiri
+38344685122
Internet Website,
Marketing...

Macron konfirmon perspektivën për anëtarësim të Ballkanit Perëndimor

PARIS, 19 JANAR - Presidenti i Francës, Emmanuel Macron, ka thënë të mërkurën se Bashkimi Evropian duhet t'i rishikojë raportet e tij me Ballkanin Perëndimor. Ai ka thënë se shteteve të Ballkanit, BE-ja duhet t'u ofrojë perspektivë "të sinqertë" për anëtarësimin në bllokun evropian.

Nga shtetet e Ballkanit Perëndimor, Serbia dhe Mali i Zi kanë përparuar më shumë në bisedimet për anëtarësim në BE. Maqedonia e Veriut dhe Shqipëria kanë dështuar që t'i nisnin bisedimet për anëtarësim për shkak se Bullgaria ka vendosur veto duke u thirrur në mosmarrëveshjet që ka me



Shkupin sa i përket historisë dhe gjuhës. Ndërkaq, Kosova dhe Bosnja e Hercegovina janë të fundit në procesin e integritimit drejt BE-së.

Franca, e cila që nga 1 janari ka marrë kryesimin gjashtëmuor të Presidencës së BE-së, ka dhënë sinjale se do ta ketë në fokus të Presidencës rajonin e

Ballkanit Perëndimor.

Gjatë një fjalimi të ndarë para Parlamentit Evropian, Macron foli edhe për tensionet në rritje në mes të Ukrainës dhe Rusisë. Ai tha se shtetet e BE-së duhet të punojnë së bashku për një stabilitetin dhe sigurinë, për të cilën më pas do të mund të diskutonin me Rusinë.

Duke iu referuar si "përpjekje destabilizuese" në kontinent, Macron, duke folur në cilësinë e kryesuesit të Presidencës së BE-së, tha se Evropa dëshiron të gjejë një përgjigje politike për konfliktin në Ukrainë.

"Siguria e kontinentit tonë është e pandashme", tha

Macron duke iu referuar Rusisë. Ai shtoi se Evropa duhet t'i definojë standardet e saj të sigurisë.

Macron tha se Evropa duhet ta "sjellë veten në pozicion që (standardet) të respektohen", por nuk dha më shumë hollësi. Më herët gjatë ditës, sekretari amerikan i Shtetit, Antony Blinken, që po qëndron në Kiev, paralajmëroi se Rusia mund të nisë një sulm të ri ndaj Ukrainës. Kiev dhe Perëndimi janë të shqetësuar se Rusia është duke u përgatitur që ta pushtojë Ukrainën, pasi Moska ka grumbulluar rreth 100 000 trupa përgjatë kufirit që i ndanë këto dy shtete.

Dorëzohet mocioni për rrëzimin e qeverisë së Krivokapiqit

PODGORICË, 19 JANAR - Në Kuvendin e Malit të Zi më 19 janar u dorëzua nisma për një mocion mosbesimi ndaj qeverisë malazeze të kryeministrit Zdravko Krivokapiq. Për dorëzimin e kësaj nisme në procedurë parlamentare njoftoi Lëvizja Qytetare Ura e udhëhequr nga zëvendëskryeministri Dritan Abazović.

Kjo nismë është nënshkruar nga anëtarët e koalicionit "E zeza mbi të bardhë", Lëvizja Ura dhe Lidhja e Qytetarëve CIVIS, që janë pjesë e koalicionit aktual qeverisës si dhe partitë opozitare Partia Socialdemokratike, Partia Boshnjake, Lista Shqiptare, Koalicioni Shqiptar dhe një pjesë e Partisë Demokratike të Socialistëve të presidentit të Malit të Zi, Millo Gjukanović. "Kjo nismë do të tregojë nëse qeveria aktuale e ka mbështetjen e shumicës së deputetëve, por edhe për modelin e propozuar për krijimin e një qeverie të pakicës", tha Ura.

Më 17 janar Lëvizja Ura dhe Lidhja Qytetare CIVIS propozuan formimin e një qeverie të pakicës

si model për tejkalimin e krizës politike disamujore. Ata janë pjesë e koalicionit qeverisës së bashku me partinë pro-serbe, Fronti Demokratik dhe Demokratët, me të cilët fituan 41 nga 81 vendet në zgjedhjet e gushtit të vitit 2020.

Inicimi i mocionit për mosbesim ndaj qeverisë vjen pas njoftimit të Partisë Demokratike të Socialistëve (DPS) të Gjukanovićit se do të mbështesë çdo nismë që do të çojë në largimin e qeverisë aktuale të Malit të Zi. Ura dhe CIVIS, megjithatë, kanë thënë se partia e Gjukanovićit nuk do të kishte vend në një qeveri të pakicës.

Kryeministri i Malit të Zi, Zdravko Krivokapiq, kundërshtoi ashpër paralajmërimin për formimin e një qeverie të pakicës, duke e cilësuar si "mashtim" këtë nismë. Ndërkaq i dërguari i posaçëm i Shteteve të Bashkuara të Amerikës për Ballkanin Perëndimor, Gabriel Escobar, ka deklaruar për mediumin malazias "Vijesti" më 19 janar se Shtetet e Bashkuara do të punojnë me çdo qeveri që do të formohet në mënyrë demokratike, për ta mbështetur



rugën e këtij shteti në integritet euro-atlantike.

Për ta iniciuar shkarkimin e Qeverisë në Kuvend nevojiten 27 vota, ndërsa për largimin e saj duhet një shumicë prej 41 deputetësh.

Me mbështetjen e DPS-së, e cila ka 30 deputetë në parlamentin malazias, Lëvizja Ura siguron numrin e mjaftueshëm të votave për një mocion mosbesimi ndaj qeverisë së kryeministrit Zdravko Krivokapiq.

Qeveria e Krivokapiqit, e cila ka një votë më shumë se sa duhet në Parlament, ka humbur mbështetjen e shumicës qeverisëse, kryesisht të partisë pro-serbe, Frontit Demokratik (DF). Megjithatë, Fronti Demokratik nuk ka nisur asnjëherë një nismë formale për të shkarkuar qeverinë, e cila nuk ka pasur mbështetjen e kësaj partie që nga mesi i vitit të kaluar.

Ndër të tjera, DF-ja nuk është pajtuar me miratimin e Rezolutës

për Srebrenicën në Parlamentin e Malit të Zi, si dhe me shkarkimin e ministrit Vladimir Llesposaviq për shkak të mohimit të gjenocidit në Srebrenicë.

Qeveria e Zdravko Krivokapiqit u zgjodh më 4 dhjetor 2020 me votat e Frontit Demokratik, Demokratëve dhe Lëvizjes Qytetare Ura si qeveria e ekspertëve, kurse i vetmi politikan në të është kreu i Lëvizjes Ura, Dritan Abazović, që mban postin e zëvendëskryeministrit.

Gjermania thyen edhe një rekord të të infektuarve

BERLIN, 19 JANAR - Gjermania ka regjistruar mbi 100 000 raste të reja me koronavirus për herë të parë që prej shpërthimit të pandemisë.

Të dhënat nga Instituti "Robert Koch" të mërkurën kanë treguar se 112 323 raste të reja janë regjistruar në 24 orë.

Të premtën për herë të parë

janë regjistruar mbi 90 000 raste të reja me koronavirus.

Mesatarja e shtatë ditëve të fundit tregon se 584 persona janë infektuar për 100 000 banorë në këtë shtet. Në gjithë Gjermaninë është raportuar për 239 viktima me koronavirus në periudhë njëditore.

Sipas Institutit "Robert Koch",

Gjermania ka regjistruar mbi 8 milionë raste të infektimit me koronavirus që prej shpërthimit të pandemisë.

Shifra e vërtetë besohet se është shumë më e lartë, pasi shumë infektime nuk janë identifikuar. Deri të martën është raportuar për 3.17 shtrirje në spital në 100 000 persona.



Rritje e madhe e rasteve me Covid në Kosovë, për 24 orë mbi 2 000 raste

EPOKA
ERE

Faton DËRMAKU

PRISHTINË, 19 JANAR - Ministria e Shëndetësisë ka njoftuar se më 19 janar në Kosovë janë regjistruar 2 050 raste të reja me Covid-19. Kjo shifër paraqet një rritje të madhe krahasuar me një ditë më parë, kur u regjistruan 720 infektive.

Rastet e reja dalin pas testimit të 9 194 mostrave, që i bie se 22.29 për qind e të testuarve kanë rezultuar pozitivë për sëmundjen Covid-19.

Në raportin që u referohet të dhënave të 24 orëve paraprake, MSh-ja ka bërë me dije se janë shëruar edhe 462 pacientë.

Ndërkaq, raste aktive me Covid-19 janë 7 266.

Sa i përket vaksinimit, autoritetet kanë administruar edhe 5 348 doza të reja të vaksinës kundër koronavirusit.

Deri më tani me dy doza të vaksinës janë imunizuar 798 225 persona

apo 44 për qind.

Në Kosovë personat mbi 12 vjeç mund të vaksinohen kundër koronavirusit. Ndërkaq, qytetarët mbi 18 vjeç, që janë imunizuar me dy doza para tre muajsh, mund ta marrin dozën përforcuese apo dozën e tretë të vaksinës.

Në Shërbimin Spitalor Klinik dhe Universitar të Kosovës në trajtim mjekësor janë 90 pacientë nga Covid-19. Prej këtyre, 52 janë të konfirmuar me Covid-19 pozitivë dhe 38 të tjerë post-Covid.

Me oksigjenoterapi janë 34 pacientë, kurse në Mjekimin Intensiv të Klinikës Infektive janë 2 pacientë me maskë oksigjeni.

Instituti Kombëtar i Shëndetësisë Publike i Kosovës (IKShPK) ka njoftuar se varianti i Covidit, Omicron, ka shtuar dukshëm intensitetin dhe është varianti dominues në qarkullim. "Virusi është kudo andaj mos neglizhoni rekomandimet themelore:



maskën, distancën, higjienën", ka njoftuar ky institut. IKShPK-ja ka njoftuar se situata

epidemiologjike mund të përkeqësohet edhe më shumë ditët në vazhdim. "IKShPK apelon te të

gjithë qytetarët që të respektohen masat e Qeverisë së Republikës së Kosovës", ka theksuar IKShPK-ja.

Paralajmërohet vizita e Lajçakut dhe e Escobarit në Prishtinë dhe Beograd



PRISHTINË, 19 JANAR - Ndonëse nuk është konfirmuar zyrtarisht, i dërguari i posaçëm i Bashkimit Evropian për dialog, Miroslav Lajçak, pritet t'i vizitojë Kosovën dhe Serbinë në fund të muajt janar dhe në fillim të muajt shkurt në kuadër të përpjekjeve për të organizuar takime të reja të dialogut. Kështu kanë thënë burimet diplomatike në Bruksel. Të njëjtat nuk e kanë mohuar se në disa prej takimeve që Lajçak do të ketë në Prishtinë dhe Beograd, mund të jetë i shoqëruar edhe nga i dërguari amerikan për Ballkanin

Perëndimor, Gabriel Escobar. Sipas burimeve në Bruksel, "akoma janë duke u përgatitur detajet e takimeve". Pritjet janë që Lajçak dhe Escobar të jenë në Prishtinë më 1 dhe 2 shkurt, ndërsa më parë do ta vizitojnë Beogradin. "Takimet dhe udhëtimet e të dërguarit të posaçëm të BE-së janë pjesë përbërëse e punës së tij të përditshme, të cilat ne nuk i komentojmë e as paralajmërojmë nga selia në Bruksel. Nëse i dërguari i posaçëm shkon për t'i takuar partnerët në rajon,

njoftimet për medie bëhen nga delegacionet përkatëse në terren, nëse një gjë e tillë është e përshtatshme", është përgjigjur zëdhënësi i BE-së, Peter Stano, në pyetjen se a është planifikuar një vizitë e përbashkët e të dërguarit të posaçëm të BE-së, Lajçak, në Prishtinë dhe Beograd nga 31 janari deri më 2 shkurt. Burimet në Bruksel kanë paralajmëruar se presin që në dialog të hapet edhe çështja e organizimit të votimeve për zgjedhjet e Serbisë në territorin e Kosovës.

Ka pritur që një zgjidhje eventuale të gjendet para zgjedhjeve parlamentare të Serbisë që zhvillohen në fillim të muajt prill. Qeveria e Kosovës nuk është pajtuar që të lejohen votimet për referendumin e Serbisë, të mbajtur të dielën, më 16 janar. Blloku evropian ka shprehur keqardhje edhe pas përfundimit të këtij referendumi. Kryeministrja serbe Ana Bërnabiq pritet ta vizitojë Brukselin javën e ardhshme, e cila ka paralajmëruar se do të kërkojë nga BE-ja që serbëve në Kosovë t'u

mundësohet votimi në zgjedhjet e Serbisë. Për një kohë të gjatë nuk ka pasur takime në kuadër të dialogut. Blloku evropian ka pasur ambicie që të zhvillojë një takim të nivelit të lartë, në fund të vitit të kaluar, mirëpo diçka e tillë nuk ka ndodhur me sqarimin se palët nuk kanë shprehur vullnet të duhur për të arritur ndonjë rezultat. Dialogu në mes të Kosovës dhe Serbisë, me ndërmjetësim të Bashkimit Evropian, ka nisur më 2011. (rel)



KRYEMINISTRI I KOSOVËS, ALBIN KURTI, KA MBAJTUR KONFERENCË PËR MEDIE PËR SHTRËNJTIMIN E ÇMIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE

Kurti fajëson qeveritë e kaluar për shtrenjtimin e energjisë elektrike

Kryeministri i Kosovës, Albin Kurti, ka fajësuar qeveritë e kaluar për shtrenjtimin e energjisë elektrike. Në një konferencë për medie ai ka thënë se edhe pas dy dekadave Kosova nuk ka shtuar kapacitetet e prodhimit në KEK. Sipas tij, qeveritë e kaluar kanë investuar mbi një miliard euro në KEK, ndërsa gjendja ka mbetur ashtu siç ishte pasluftës. Ish-kryeministri Abdullah Hoti, as Ramush Haradinaj, nuk janë pajtuar me pretendimet e kryeministrit aktual. Ata e kanë fajësuar Kurtin për mungesë të vizionit në këtë drejtim. Sipas tyre, shtrenjtimi i rrymës është i papërbalueshëm për qytetarët

vendimeve. “Si pasojë e krizës globale që ka shkaktuar rritjen e çmimeve të energjisë dhe për shkak të avarive në termocentralet e KEK-ut që e kanë rritur nevojën për importin e energjisë, ZRrE ka filluar shqyrtimin e tarifave. Ligjërisht ZRrE-ja dhe bordi i saj janë të pavarura dhe s’mund të ndikohen nga qeveria për marrjen e vendimeve të tyre. Qeveria e Kosovës ka shprehur gatishmërinë që të ndajë një subvencion deri në 75 milionë euro për konsumatorët shtëpiakë deri në 600 kWh dhe ata biznesorë të mos ketë shtrenjtim të çmimit të energjisë”, është shprehur Kurti. Ai është shprehur se janë dy faktorë që kanë shkaktuar krizën energjetike. “E kemi thënë edhe në konferencat e mëhershme, se janë dy faktorë që kanë bërë që të kemi këtë krizë. Njëri është i jashtëm, Kosova një sasi të kërkesës e mbulon nga importi, rrjedhimisht çmimet e larta në bursën ishin jashtëzakonisht të mëdha. Faktori tjetër është fakti se Kosova u është lënë në mëshirë tregtarëve të energjisë. Në vend se të investohet për zgjerimin e gjenerimit të energjisë, politikanët u kanë dhënë prodhuesve të tjerë në shtetet e rajonit”, ka thënë Kurti.

Rizvanolli: S’mund të ndërhyjmë në vendimet e ZRrE-së

Ministrja e Ekonomisë, Artane Rizvanolli, gjatë konferencës me kryeministrin, ka thënë se propozimi i Zyrës së Rregullatorit për Energji (ZRrE) për shtrenjtimin e rrymës nuk është final. Ajo ka treguar se do të kërkojnë sqarime shtesë dhe do të japin propozime aty ku mendojnë se gjërat mund të bëhen më mirë. “Propozimi i ZRrE-së nuk është final. Ai është në diskutim publik. Ne do ta trajtojmë raportin. Do të kërkojmë sqarime shtesë dhe do të japim edhe propozime për ato ku mendojmë se gjërat mund të bëhen më mirë, mirëpo një gjë është e qartë dhe ka qenë e qartë edhe para se ta shohim këtë raport”, ka thënë ajo. Ministrja Rizvanolli ka përsëritur njoftimin se kostot e importit të energjisë elektrike janë rritur shumë, ndërsa ka theksuar se subvencionimi nga qeveria është i pashmangshëm. Rizvanolli ka thënë se ndihma e qeverisë do ta zbusë shtrenjtimin e rrymës, ndërsa ka theksuar se ekzekutivi nuk mund të ndërhyjë në vendimet e

ZRrE-së. “Qeveria nuk miraton, as nuk ka përgjegjësi në vendimet e Zyrës së Rregullatorit të Energjisë dhe ndërhyrja në vendimet e tyre do të ishte e jashtëligjshme. Mirëpo ne zotohemi se çfarëdo vendimi që ZRrE-ja do ta marrë, ne do të përkushtohemi të ndihmojmë përmes instrumenteve që i kemi në dispozicion për ta siguruar sigurinë e furnizimit me energji elektrike, mbrojtjen e konsumatorëve, në radhë të parë atyre që e shfrytëzojnë energjinë elektrike racionalisht sipas nevojës si dhe në mbrojtje të vendeve të punës”, ka thënë ajo.

Ish-kryeministrat: Rritja e çmimit të energjisë, e papërbalueshme

Ish-kryeministrat e Kosovës, Avdullah Hoti dhe Ramush Haradinaj, kanë kritikuar kryeministrin aktual Albin Kurti për rritje të çmimit të energjisë elektrike. Të dytë kanë fajësuar Kurtin për mospërkrahjen e projektit të gazit me MCC-në. “Çmimi i energjisë nuk duhet të rritet nën presione momentale të tregut. Çmimi i energjisë duhet të rritet vetëm si rezultat i një strategjie afatgjatë të

**EPOKA
ERE**

Muhamet KOCI

Prishtinë, 19 janar - Kryeministri i Kosovës, Albin Kurti, është munduar ta arsyetojë shtrenjtimin e energjisë elektrike një ditë pasi Zyra e Rregullatorit për Energji (ZRrE) ka propozuar bllok tarifave për çmim të energjisë. Fajin për gjendjen e krijuar në fushën e energjisë ua ka hedhur qeverive të kaluar të Kosovës. Në një konferencë të përbashkët për medie me ministren e Ekonomisë, Artane Rizvanolli, Kurti ka thënë se, pavarësisht prej investimeve miliardëshe, qeveritë e kaluara nuk kanë shtuar kapacitetet për prodhimin e energjisë. “Me vite

janë mbajtur kosto fiktive për qëllime elektorale, për më tepër janë larguar masat siç janë bllok tarifave. Heqja e bllok tarifave ka qenë gabim shumë i madh. Ato dëme i kemi ndierë tani. Kjo krizë vetëm sa ka thelluar atë që po paguajmë. Fatura që po paguajmë është ajo e mosveprimit të më se dy dekadave për zhvillimin e qëndrueshëm të furnizimit me energji elektrike. Në të njëjtën kohë jemi duke ndierë vjetërsinë e termocentraleve. Në vend se të investohet në zgjerimin e rritit të ngrohjes qendrore, kanë bërë ndërtimin e mijërave banesave që varen nga energjia elektrike”, ka thënë Kurti.

Ai ka thënë se bordi i ZRrE-së është i pavarur për marrje të

Gjykata Supreme i jep të drejtë vendimit të BQK-së për KS “Kosova e Re”

PRISHTINË, 19 JANAR - Gjykata Supreme ka refuzuar të pabazuar kërkesën për rishqyrtim të jashtëzakonshëm të vendimit gjyqësor, të paditësit - propozuesit Shoqëria “Fitorja” Sh.P.K., e përfaqësuar nga Naser Maloku, menaxher dhe aksionar i vetëm i kompanisë së Sigurimeve “Kosova e Re” Sh. A., të ushtruar kundër aktvendimit të Gjykatës së Apelit në Prishtinë, AA nr. 998/2021, të datës 16.11.2021. “Me aktvendimin e Gjykatës së Apelit në Prishtinë,

AA nr. 998/2021, të datës 16.11.2021, është aprovuar ankesa e BQK-së dhe është refuzuar kërkesa e propozueses, Shoqëria ‘Fitorja’ Sh.P.K., e përfaqësuar nga Naser Maloku -menaxher dhe aksionar i vetëm i kompanisë së Sigurimeve ‘Kosova e Re’ Sh. A., për shtyrjen e ekzekutimit të vendimit të të paditurës Banka Qendrore e Republikës së Kosovës, me seli në Prishtinë, me nr. 70-24/2021, të datës 24.09.2021”, ka njoftuar BQK-ja. Sipas vlerësimit të kësaj

gjykate, aktvendimi i Gjykatës së Apelit është i qartë, i kuptueshëm dhe i arsyetuar mjaftueshëm për të gjitha faktet vendimore që kanë rezultuar me marrjen e tij, duke u bazuar edhe në dispozitat ligjore të Ligjit për BQK-në, të cilat rregullojnë ndalimin e shqiptimit dhe ekzekutimit të ndonjë mase, para se të nxirret vendimi përfundimtar gjyqësor në çdo veprim ligjor të parashtruar para gjykatave të Republikës së Kosovës.



OBSH-ja: Pandemia nuk është as afër fundit



GJENEVË, 19 JANAR - Pandemia e koronavirusit nuk është “as afër fundit”, ka thënë Organizata Botërore e Shëndetësisë (OBSH), ndërkohë që varianti Omicron i koronavirusit ka përballur shumë shtete me rekord të infektiveve me koronavirus. Shefi i OBSH-së, Tedros Adhanom Ghebreyesus, ka bërë thirrje për kujdes ndaj pretendimeve se varianti Omicron përbën më pak rrezik, vetëm sepse duket se shkakton simptoma më të lehta. “Omicron mund të jetë më pak i ashpër, mirëpo pretendimet se është sëmundje e lehtë është mashtrim”, u ka thënë ai

gazetarëve nga selia e OBSH-së në Gjenevë. “Mos u gaboni: Omicron është duke shkaktuar shtrirje në spital dhe vdekje, andaj edhe rastet më të lehta janë duke ngarkuar sistemin shëndetësor”, ka shtuar ai. Varianti Omicron i koronavirusit tani është dominues në shumë vende të botës, duke nisur nga Brazili e deri në Francë. Të dhënat sugjerojnë se vaksinat ekzistuese për koronavirus janë më pak efektive për parandalim të infektimit me Omicron në krahasim me variantet e tjera, mirëpo dozat e vaksinave

ofrojnë mbrojtje ndaj sëmurjes së rëndë dhe vdekjes. Ekziston shpresë se kombinimi i njerëzve të vaksinuar dhe pjesën tjetër që ka antitropa nga infektimi me koronavirus mund të rezultojë me një shkallë të atij që njihet si imunitet i tufës. Kjo gjë ka rritur diskutimet nëse koronavirusi do të kthehet në endemi. Michael Ryan, drejtor për Emergjencë në OBSH, ka thënë, në një panel të organizuar nga Forumi Ekonomik Botëror, se “ky virus mund të mos përfundojë kurrë”, sepse një virus i tillë “mund të bëhet pjesë e ekosistemit”.

investimeve në energji për t'i reflektuar kostot e investimeve të cilat duhet të jenë të arsyetuara në detaje. Në afat të shkurtër janë dy masa që duhen ndërmarrë. E para, duhet të bëhet subvencionimi i energjisë. Kjo është forma e vetme për ta parandaluar rritjen e çmimit për konsumatorë dhe biznese”, ka shkruar Hoti në profilin e vet në “Facebook”. Sipas tij, masa e dytë që duhet ta ndërmarrë qeveria është konsultimi me ekspertët e fushës dhe me disa ndryshime eventuale. “Duhet konsideruar kthimi i sistemit të mëparshëm të tarifave të energjisë për ta nxitur kursimin e energjisë. Raporti i fundit i ZRRE-së tregon qartë se rritja e konsumit të energjisë në tri vjetët e fundit në masë të madhe i atribuohet ndryshimit të strukturës së tarifave të energjisë në vitin 2017. Me tarifatat ekzistuese duket se nuk ka nxitje të mjaftueshme për kursim të energjisë”, ka vlerësuar Hoti. Në aspektin afatgjatë, ai ka thënë se detyruesisht duhet të rriten kapacitetet dhe të sigurohet pavarësia energjetike. Sipas Hotit, kjo bëhet përmes katër masave, projektit të MCC-së, investimit në rivitalizim të termocentraleve Kosova A dhe Kosova B përmes teknologjisë

moderne që përmbush në masë të pranueshme kriteret ambientaliste, investimet në kapacitete energjetike duhet të bëhen në kontekst të qasjes komplementare në furnizim energjetik me Shqipërinë, dhe duhet zgjeruar shumë më tepër programet ekzistuese të masave për kursim të energjisë në amvisëri Edhe kryetari i AAK-së, Ramush Haradinaj, ka reaguar sërish sa i përket çmimit të energjisë elektrike në vend. Përmes një postimi në llogarinë e vet në “Facebook”, ka shkruar se çmimi i mashtrimit, pasojë e mosdijes apo interesave klienteliste. “Qasja e Albin Kurtit për energjinë në vazhdimësi ka qenë problematike. Kur ishte në opozitë ka kundërshtuar ndërtimin e Kosovës së Re, me arsyetimin se do të dilte rryma më shtrenjtë, megjithëse çmimi i saj po rezulton se do të na dilte për disa herë më i lirë. Sapo ka ardhur në qeveri, me arsye qesharake, për të mos thënë banale, e ka refuzuar gazin amerikan, që do të ishte një burim shtesë i prodhimit të energjisë. Ka shpenzuar dhjetëra milionë për pagesën e rrymës për qytetarët serbë në veri. Njëkohësisht ka vazhduar ta subvencionojë blerjen e rrymës

Item	Unit	Price (€ cent)	Suma (€)
16590.00			
44236.00			
16503.00			
43978.00			
87.00			
266.00			
87.00			
266.00			
49	0.0555	2.72	
151	0.0279	4.21	
38	0.0770	2.93	
115	0.0386	4.44	
0	0.1117	0.00	
0	0.0558	0.00	

me dhjetëra milionë të tjerë të taksapaguesve”, ka shkruar Haradinaj. Sipas tij, shtrenjtimi i energjisë për qytetarët është bërë në një masë të papërbalueshme. “Kam dashur të besoj se të gjitha këto veprime të palogjikshme të tij në raport me energjinë kanë qenë rezultat i mungesës së dijes dhe përvojës së tij qeverisëse, por kanë ndodhur aq shumë veprime skandaloze sa që të krijohet bindja se të gjitha këto janë bërë me skenar për të shkaktuar një situatë të

papërbalueshme për qytetarin e shumë profitabile për mafien energjetike. Prandaj pyetja ime publike është nëse të gjitha veprimet për energjinë fshehin diçka më të madhe sesa mungesa e përvojës së kryeministrit. A mos ka këtu interesa klienteliste të qeverisë e të një pjese të opozitës që po hesht”, ka shkruar Haradinaj. Një ditë më parë u prezantua propozimi i Zyrës së Rregullatorit për Energji (ZRRE) për rritjen e çmimit të energjisë elektrike. ZRRE-ja ka propozuar rivendosjen

e bllok tarifës deri në 600 KWh për konsumatorët e amvisërisë si dhe që tarifën e energjisë elektrike të ngriten për 9 për qind për të gjithë konsumatorët komercialë dhe konsumatorët e amvisërisë që konsumojnë deri në 600 KWh. Sipas propozimit, tarifatat për konsumin e amvisërisë mbi 600 KWh do të reflektonin çmimin e importit. Qeveria e Kosovës ka zotuar 75 milionë euro për subvencionimin e energjisë elektrike për qytetarët dhe bizneset.

Nga sot testet rapide në Prishtinë bëhen shtatë ditë në javë

PRISHTINË, 19 JANAR - Drejtori i Qendrës Kryesore të Mjekësisë Familjare në Prishtinë, Bujar Gashi, ka njoftuar se nga sot (e enjte) në komunën e Prishtinës do të bëhen teste rapide në shtatë ditë të javës. Gashi ka njoftuar se këto teste do të bëhen në Qendrën e Studentëve nga

ora 08:00-18:00. Ky vendim, sipas Gashit, ka ardhur pas shtimit të fluksit të qytetarëve që kërkojnë të testohen për Covid-19. "Njoftohen qytetarët e komunës së Prishtinës se nga data 20.01.2022 Qendra e Studentëve ku bëhen testet rapide-antigen do të punojë

7 ditë të javës me këtë orar: 08:00-18:00. Ky vendim është marrë në përgjigje të rritjes së numrit të qytetarëve që kërkojnë të testohen me testet rapide antigjenike. Vetëm dje me dt. 18.01.22 kishim 403 teste!", ka shkruar Gashi në llogarinë e vet "Facebook".



Tri shkolla në Gjakovë fillojnë mësimin online

GJAKOVË, 19 JANAR - Kryetari i komunës së Gjakovës, Ardian Gjini, ka marrë pjesë në mbledhjen e Shtabit Emergjent për menaxhimin e Covid-19, ku është njoftuar me situatën epidemiologjike në këtë komunë.

Gjatë këtij takimi Gjini është informuar se ka rritje të rasteve me Covid në Gjakovë, po ashtu është njoftuar se ka edhe ngritje të vetëdijesimit për t'u vaksinuar si dhe për t'u testuar nga ana e qytetarëve.

Aktualisht në Gjakovë janë gjithsej 256 raste aktive me këtë virus. Ndërkaq, për shkak të rritjeve të rasteve tri shkolla të komunës po vazhdojnë mësimin online.

Ushtruesja e detyrës e drejtorit të

Spitalit të Përgjithshëm "Isa Grezda", Ardian Jusufi, ka thënë se në këtë institucion shëndetësor gjendja është stabile, duke iu referuar faktit që numri i të hospitalizuarve me Covid-19 është i vogël.

Gjatë këtij takimi anëtarët e shtabit u pajtuan për bashkëpunim të ndërsjellë për menaxhim sa më të mirë të situatës me Covid-19.

Ndërsa kryetari Gjini edhe një herë u shpreh i gatshëm që të jetë afër tyre për të kryer çdo detyrë që i takon institucionit të komunës së Gjakovës. Ata u bënë thirrje të gjithë qytetarëve që të vazhdojnë të tregohen të kujdesshëm duke respektuar masat e vendosura nga institucionet relevante.



Pas rritjes së rasteve me Covid, Bulliqi viziton QKMF-në në Podujevë



PODUJEVË, 19 JANAR - Bazuar në situatën e fundit epidemiologjike në vend, veçmas në komunën e Podujevës, kryetari i komunës së Podujevës, Shpejtim Bulliqi, ka vizituar Qendrën Kryesore të Mjekësisë Familjare (QKMF) dhe Shkollën Fillore dhe të Mesme të Ulët "Shaban Shala". Pas vizitës në QKMF, Bulliqi së bashku me drejtorin e Shëndetësisë, Driton Veliu dhe udhëheqjen e kësaj qendre, kanë bërë me dije se janë këtu për t'u njohur nga afër me situatën dhe për ta ofruar gjithë mbështetjen e nevojshme institucionale për përballje sa më të suksesshme të kësaj situatë.

Gjatë kësaj vizite kryetari Bulliqi me bashkëpunëtorë ka vizituar Qendrën e Vaksinimit dhe

Qendrën Anticovid ku është njoftuar me numrin e rasteve dhe statistikën e vaksinimit deri më tani. "Nga informacionet që mora trendi i të infektuarve ditët e fundit ka shënuar rritje dhe aktualisht në komunën tonë kemi 110 raste aktive me Covid-19. Për fatin e mirë nuk kemi asnjë të hospitalizuar. Ndërsa janë rreth 80 mijë doza vakcina të administruara", ka thënë Bulliqi. Në këtë kuadër ai, gjithashtu, ka vizituar edhe Shkollën Fillore dhe të Mesme të Ulët "Shaban Shala", ku është njoftuar nga afër me zhvillimin e procesit mësimor në këtë shkollë, ku disa mësimdhënës kanë rezultuar pozitivë me Covid-19 dhe për pasojë dy paralele po zhvillojnë mësimin online.

Kryetari i Kamenicës pret në takim investitorët zviceranë

KAMENICË, 19 JANAR - Kryetari i komunës së Kamenicës, Kadri Rahimaj, ka pritur në takim investitorët zviceranë Oliver Fiechter dhe Georg von Waldenfels. Në këtë takim është diskutuar për mundësitë e investimit nga investitorët në komunën e Kamenicës. I pari i komunës ka thënë se projektet inovatore të cilat u janë paraqitur në këtë takim janë të rëndësishme për komunën.

"Sot prita në takim z. Oliver Fiechter dhe z. Georg von Waldenfels. Të dy këta investitorë zviceranë janë me emër në tregun në të cilin bëjnë pjesë. Bashkë me ta në takim ishte i pranishëm edhe këshilltari i zëvendëskryeministrit Bislimi, z. Bejtush Fetija. Diskutuam për bashkëpunime konkrete si dhe mundësi të investimit nga ana e tyre në komunën e

Kamenicës. Projektet inovatore të tilla, të cilat na u paraqitën sot, janë të rëndësishme edhe për komunën tonë si nisje, për të vazhduar më pas edhe si investime jo vetëm për Kosovë, por edhe për rajon. Shprehja gatishmërinë që si komunë jemi të hapur për bashkëpunim si dhe për ide dhe nisma të tilla", ka thënë kryetari Rahimaj.



Kryetarët e komunave kërkojnë zgjidhje urgjente për zbatimin e kontratës kolektive

EPOKA
ERE

Qendresa RAMA

PRISHTINË, 19 JANAR - Në takimin e Asociacionit të Komunave të Kosovës të Këshillit të Kryetarëve të Komunave të Republikës së Kosovës është biseduar edhe për problemet e komunave për zbatimin e kontratës kolektive në arsim dhe shëndetësi.

Kryetari i Asociacionit të Komunave të Kosovës, Imri Ahmeti, ka paraqitur sfidat dhe problemet buxhetore të komunave me rastin e zbatimit të njëanshëm të pjesëve të caktuara të kontratës kolektive nga përmbaruesit privatë. Ahmeti ka theksuar se komunat nuk kanë qenë palë në nënshkrimin e marrëveshjes së kontratës kolektive për arsim dhe shëndetësi.

Kryetarët e komunave të cilët paraqiten hollësisht problemet e tyre në këtë drejtim ritheksuan se kjo situatë e rënduar ku përmbaruesit po tërheqin mjetet



buxhetore nga buxhetet komunale mund të mbingarkohet në muajt në vazhdim deri në prishjen e skemave buxhetore komunale. Ata thanë se janë duke paguar dëmin që ka sjellë nënshkrimi i marrëveshjes për kontratën kolektive për arsim dhe shëndetësi nga ministrinë përkatëse pa konsultim me

komunat.

Kryetarët e komunave, në lidhje me këtë çështje, u pajtuan me këto konkluzione: 1. Kryetarët e komunave nuk janë kundër kontratës kolektive; 2. Të gjendet zgjidhje urgjente në mënyrë që të mos preken buxhetet komunale si pasojë e vendimeve dhe marrëveshjeve të ministrive pa

konsultim me komunat; 3. Derisa nuk jemi palë nënshkruese si komunë, zgjidhja duhet të gjendet jashtë buxheteve komunale që po dëmton më së shumti investimet kapitale; 4. Obligimet që dalin nga zbatimi i kontratës kolektive të mbulojnë nga ministrinë që kanë nënshkruar këtë kontratë; 5. Kryetarët e komunave propozojnë

edhe si ide që obligimet që dalin nga kontrata kolektive të inkorporohen me Ligin e Pagave; 6. Tërheqja e mjeteve nga përmbaruesit pa dëshirën e komunave po ndikon edhe në vlerësimet e Auditorit të Përgjithshëm të Kosovës për komunat në auditimin e pasqyrave financiare.

IKD-ja e vlerëson të mangët Projektligjin për Konfiskim të Pasurisë



PRISHTINË, 19 JANAR - Instituti i Kosovës për Drejtësi (IKD) ka paraqitur analizën "Konfiskimi i pasurisë së pajustificueshme: problemet juridike të projektligjit aktual". Gjatë paraqitjes së kësaj analize u tha se me këtë projektligj shfaqen shumë paqartësi sa i përket udhëheqjes së drejtorit të kësaj byroje dhe shkarkimit të tij nga ana e Kuvendit.

Hulumtues i lartë në IKD, Gzim Shala, ka thënë se, sipas projektligjit të miratuar nga Qeveria e Republikës së Kosovës, Byroja Shtetërore për Verifikimin dhe Konfiskimin e Pasurisë së Pajustificueshme objektivisht nuk mund të jetë e pavarur. "Byroja udhëhiqet nga drejtori i përgjithshëm dhe konform këtij projektligji, drejtori i përgjithshëm është autoriteti kryesor për fillimin e verifikimit të pasurisë dhe fillimin e

procedurave të konfiskimit. Problemi qëndron në atë se drejtori i përgjithshëm emërohet me shumicë të thjeshtë nga Kuvendi (me shumicën e votave të deputetëve të pranishëm dhe që votojnë), pas propozimit të komisionit mbikëqyrës të Kuvendit. Shto këtu që mandati i drejtorit ka garanci tejet minimale, ku i njëjti mund të shkarkohet mbi bazën e paprecizuar sa duhet të 'dëshimit për përmbushjen e mandatit ligjor'. Në rrethanat të tilla është e pamundur që byroja të mund të cilësohet si institucion i pavarur dhe i paanshëm në ushtrimin e detyrave. Drejtori i përgjithshëm do të varet tërësisht nga partitë në pushtet, përkatësisht me ndërrimin e shumicës parlamentare në Kuvend, nën rregullimin aktual do të ndërrojë edhe drejtori i përgjithshëm", ka theksuar Shala.

Salih Mustafa s'ka ushtruar dhunë ndaj askujt, ai ka përjetuar tortura nga pushteti serb

HAGË, 19 JANAR - Ish-pjesëtari i Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës (UÇK), Fatmir Sopi, i cili po dëshmon në gjykimin ndaj Salih Mustafës në Hagë, ka thënë se në shtëpitë në Zllash ku kanë qëndruar ushtarët e UÇK-së nuk është maltretuar askush. Ai ka thënë se Salih Mustafa nuk ka trajtuar asnjë njëri mizorisht dhe se nuk ka dëgjuar diçka të tillë për ish-

bashkëluftëtarin e tij. Në ditën e dytë të dëshmisë së tij para Dhomave të Specializuara të Kosovës në Hagë, Sopi ka thënë se gjatë luftës nuk ka qenë asnjëherë pengesë orientimi politik i ushtarëve të UÇK-së. "Nuk ka mundur të ndodhë kurrë kjo. E njoh edhe para luftës, e kam njohur si ish-i burgosur politik dhe njëri i cili i ka përjetuar torturat më

çnjerëzore nga pushteti serb dhe nuk e besoj kurrë që i njëjti mund të ushtrojë dhunë ndaj dikujt për asnjë arsye dhe për asnjë rast. Kurrë në jetën time nuk kam dëgjuar diçka të tillë për bashkëluftëtarin tim zotëri Salih Mustafa", ka thënë Sopi. Ai ka theksuar se qëllimi i luftës së UÇK-së ka qenë vetëm çlirimi i vendit nga forcat serbe.



Kurti viziton AKP-në, premton përkrahje për këtë institucion

“Epoka e re”

PRISHTINË, 19 JANAR - Kryeministri Albin Kurti, së bashku me ministren e Ekonomisë, Artane Rizvanolli dhe ministrin e Financave, Punës dhe Transfereve, Hekuran Murati, ka vizituar të mërkurën Agjencinë Kosovare të Privatizimit.

Në takim me Bordin e Agjencisë Kosovare të Privatizimit, kryesuar nga Nazmi Mikollovci, u bisedua për punën e bërë nga muaji gusht i vitit të kaluar, pas votimit të bordit të ri nga Kuvendi i Republikës së Kosovës.

Kryeministri Kurti ka vlerësuar se bashkërisht janë arritur disa suksese shumë të vlefshme për interesin publik, shtetëror e ekonomik të Kosovës. Ai ka shprehur mbështetjen e plotë të qeverisë për punën e AKP-së, si dhe përkushtimin për t'i përballuar sfidat, duke mos e kursyer vullnetin dhe duke shkëmbyer përvojat dhe dijet.

Gjatë takimit u bisedua edhe për strategjinë përmbyllëse të Agjencisë Kosovare të Privatizimit, e cila tashmë është hartuar, si dhe për rrugën përpara drejt themelimit të Fondit Sovran.

Tash së fundmi qeveria e ka pranuar nga grupi punues draftin përfundimtar të koncept-dokumentit për themelimin e Fondit Sovran të Republikës së Kosovës.

Ky dokument përbën bazën konceptuale dhe strategjike për themelimin e Fondit Sovran, përfshirë konceptin dhe hapat për vendosjen e bazës ligjore dhe institucionale të Fondit.

Paralelisht me punën e këtij



grupi punues, Bordi i AKP-së ka arritur që t'i evidentojë në një regjistër të përbashkët gjithsejtë 2364 asete të AKP-së, nga të cilat, pas një analize të hollësishme e konkrete, është vlerësuar se 1 653 prej tyre do t'i barten Fondit Sovran, ndërkaq 771 do të vazhdojnë të ngelen nën portofolin e AKP-së.

Kryesuesi i Bordit të AKP-së, Nazmi Mikollovci, ka bërë me

dije se tashmë janë bërë shkurtimet e shpenzimeve, në vlerë të gjithëmbarshme mbi 2 milionë e 600 mijë euro. Kjo u vlerësua si e arritur shumë e vlefshme dhe e dobishme për agjencinë dhe Buxhetin e Republikës së Kosovës. Po në këtë takim u vlerësua lart aktivizimi i Ndërmarrjes Shoqërore “Brezovica”, e cila tashmë është vënë në funksion, në përputhje të

plotë me sistemin juridik të Kosovës.

Fiskalizimi përbrenda ligjit dhe formalizimi i kësaj ndërmarrjeje u vlerësuan si parakushte për t'ua hapur rrugën investimeve për këtë qendër tejet të rëndësishme turistike për Kosovën me potencial të madh për vendin tonë.

Kryesuesi i Bordit të AKP-së, Nazmi Mikollovci, ka falënderuar

kryeministrin dhe ministrat për vizitën dhe takimin, si dhe për përkrahjen e dhënë nga qeveria për punën dhe veprimet e muajve të fundit.

Në përmbyllje të takimit u theksua se nëpërmjet bashkëpunimit institucional do të mundësohet tejkalimi i sfidave dhe krijimi i një baze zhvillimore për Republikën e Kosovës.

Murtezaj: ATK-ja për 22 vjet ka inkasuar rreth 8 miliardë euro tatime



PRISHTINË, 19 JANAR - Rreth 8 miliardë euro janë inkasuar të hyra tatimore dhe kontribute pensionale për 22 vjet nga Administrata Tatimore e Kosovës. Në vitin 2021 ATK-ja ka shënuar rekord në mbledhjen e tatimeve, rreth 600 milionë euro tatime dhe mbi 200 milionë euro kontribute pensionale. Kështu ka thënë të mërkurën

drejtori i përgjithshëm i ATK-së, Ilir Murtezaj, me rastin e shënimit 22-vjetorit të themelimit të këtij institucioni. Murtezaj ka thënë se vitet e fundit ATK-ja ka krijuar shërbime moderne dhe digjitale për tatimpaguesit.

Ministri i Financave, Punës dhe Transfereve, Hekuran Murati, ka thënë se nga 5

milionë euro kur kishte mbledhur në vitin e parë të themelimit, ATK-ja tashmë ky institucion është bërë kontribuues kryesor për të hyrat buxhetore.

Murati ka thënë se të hyrat nga ATK-ja janë tepër të rëndësishme dhe, sipas tij, janë edhe të nevojshme për ta ruajtur produktivitetin e ekonomisë së Kosovës

Kosova nuk mund ta kontrollojë rritjen e çmimeve të produkteve ushqimore

PRISHTINË, 19 JANAR - Ministrja e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë, Rozeta Hajdari, ka thënë se rritja e çmimeve të prodhimeve ushqimore në Kosovë ka ndodhur për

shkak të rritjes së inflacionit dhe importit. Hajdari, duke diskutuar në “Fol Hapur”, ka thënë se Kosova nuk mund t'i kontrollojë çmimet. “Departamenti i Tregut ka

sjellë konkludimet se këto rritje të çmimeve janë për arsye të rritjes së inflacionit nga kriza botërore e pandemisë Covid-19 dhe, siç e dini, në Kosovë janë 90 për

qind të mallrave import, ku kryesisht është konsumi familjar dhe këto janë situatat që i kemi si vend importues”, ka thënë Hajdari.



Sfidat e sigurimit të Energjisë Elektrike me kosto të ulët, për klientët e kualifikuar

Albi GJENERALI

Prej vitesh, termi “Klient i Kualifikuar” ka vënë në pikëpyetje bizneset e lidhura në nivelet e ndryshme të tensionit mbi 0.4 kv, dhe çdo fillim viti rishfaqet gjithnjë e më i prekshëm për ta, edhe pse mbeten ende shumë aspekte për t'u zberthyer nga modeli i tregut, se si do të ndodhë realisht. Ligjërisht një “Klient i Kualifikuar” është “Një konsumator, që ka të drejtën sipas Legjislacionit në fuqi ose rregulloreve të aplikueshme të ERE-s, të zgjedhë furnizuesin e energjisë elektrike, për energjinë elektrike të përdorur për nevojat e veta.” Kjo nënkupton të zgjedhë furnizuesin, me çmime të liberalizuara, dhe ky furnizues mund të jetë cilado kompani e licencuar nga ERE si furnizues, me çmimet e rregulluara nga ERE (por jo Furnizuesi i Shërbimit Universal, që sot njihet ndryshe si OSHEE).

Me përafrimin e ligjit shqiptar të Energjisë Elektrike me Paketën e Tretë Energjitike të BE, miratuar

do të duhet të sigurojnë energjinë elektrike, proceset teknike, ligjore dhe administrative që duhen ndjekur, dhe mbi të gjitha për kostot që do të duhet të përballojnë dhe të parashikojnë në bilancet e tyre. Të gjitha këto çështje kërkojnë një trajtim të veçantë, të cilin do ta analizojmë në artikujt vijues. Në këtë publikim do të trajtojmë kostot dhe mënyrat e sigurimit të energjisë elektrike nga klientët e kualifikuar. Para se të kalojmë tek këto mënyra, po tregojmë një panoramë të kostove të energjisë elektrike në rajon dhe në vend.

Vjeshta e vitit që lamë pas e në vijim shënoi dhe çmimet me të larta të rregjistruara në histori, të energjisë elektrike, në të gjitha bursat e tregtimit nga kontinenti Amerikan deri në Azi, por mbi të gjitha në Europë. Sipas të dhënave të siguruar nga Bursa HUPX (Bursa Hungareze), që është dhe bursa referencë për tregun shqiptar, çmimet mesatare të energjisë elektrike janë 5-fishuar nga Janari në Dhjetor 2021. Po sipas të dhënave të HUPX, çmimi



konsiderojmë kostot e sigurimit të energjisë elektrike, si klient i kualifikuar. Të jesh klient i kualifikuar sot në kuptimin e kostos të sigurimit të energjisë elektrike, do të thotë që në rastin më të keq të sigurosh energjinë elektrike me kostot e bursës të HUPX, të paguash mbi këtë çmim tarifën e interkoneksionit, tarifën e transmetimit, tarifën e shpërndarjes, fitimin e furnizuesit, disbalancat e shkaktuara dhe sipas rastit, edhe tarifën e shërbimit të kompanive tregtare.

Tarifa e miratuar nga ana e ERE për transmetimin është rreth 6 Eur/Mwh, dhe ajo e shpërndarjes në nivelin e tensionit 20 Kv është 31 Eur/Mwh. Pra një energji e siguruar në bursën HUPX ndërmjet një furnizuesi në tregun e lirë e blerë me rreth 200 Eur/Mwh, do t'i kushtonte një “Klienti të Kualifikuar” në Shqipëri rreth 237 Eur/Mwh, pa llogaritur këtu fitimin e furnizuesit dhe disbalancat e mundshme. Pra 237 Eur/Mwh nga 105 Eur/Mwh që paguan sot. Diferenca financiare midis këtyre vlerave bie mbi tarifën e rregulluar të Shërbimit Universal, i cili është shërbimi që marrin klientët familjarë dhe bizneset e vogla jo-familjare të lidhura në nivelin e tensionit 0.4 Kv, shtresa vulnerabël, mbi konsumatorët e mbrojtur me ligj të cilët furnizohen nga Furnizuesi i Shërbimit Universal (FSHU). Se sa e drejtë është kjo për secilën palë në nivelin makroekonomik, i takon politikëbërësit ta përcaktojë.

Patjetër që një klient i kualifikuar ka teoritikisht dhe praktikisht mundësinë që të sigurojë furnizim me energji elektrike me çmime shumë më të lira nga sa më sipër. Sipas të dhënave të bursës HUPX, në vitin 2020, çmimi mesatar vjetor i shitjes së energjisë elektrike në këtë bursë ka qënë 39 Eur/Mwh dhe në përgjithësi ky ka qënë trendi i kësaj burse, para krizës së shfaqur në gusht të vitit 2021. Me këtë çmim burse, energjia vjen deri tek klienti i kualifikuar në Shqipëri me

vlerën e përafërt 76 Eur/Mwh, dhe duke llogaritur fitimin e furnizuesit apo dhe disbalancat, vlera do të varioje rreth 85 Eur/Mwh, vlerë e cila është e krahasueshme me çmimet që ata furnizohen sot. Kjo vlerë mund të jetë dhe më e ulët, nëse bizneset dhe linjat e prodhimit vendosin të punojnë në orare jashtë pikut, ku çmimi i energjisë është më i lirë si pasojë e kërkesës të ulur. Për ta shpjeguar më qartë: Në datën 08 Janar 2020, në orën H3, H4, H5 të mëngjesit, çmimi në bursën HUPX ka qënë mesatarisht 32 Eur/Mwh, ndërsa në orën H8, H9, H10, ka qënë 66 Eur/Mwh. Diferenca është më shumë se dyfish. Të jesh klient i kualifikuar të jep mundësinë të zgjedhësh të konsumosh në ato fasha të cilat janë jashtë pikut, kur dhe çmimi është shumë i preferuar.

Njëkohësisht, energjia për klientët e kualifikuar mund të sigurohet në tregun e brendshëm me çmime të konkurrencës, nga prodhuesit e pavarur, HEC-et që u kanë mbaruar kontratat e furnizimit me shtetin shqiptar, dhe mbi të gjitha nga investimet private në panele fotovoltaike, me një fuqi të instaluar deri në 500 Kwp.


Sipas Raportit vjetor për vitin 2020 të publikuar nga ERE, prodhuesit e pavarur dhe prodhuesit me përparësi nga burimet hidrike dhe solare kanë arritur të prodhojnë një sasi prej 2.223.000 Mwh, nga 5.313.000 Mwh që janë prodhuar në total, ose rreth 41% të prodhimit total vendas. Sipas të dhënave të disponueshme, klientët ligjërisht të kualifikuar konsumojnë rreth 37% të energjisë totale në vend, në një vlerë prej 2.807.000 Mwh. Sasia e prodhuar nga prodhuesit e pavarur dhe ato me përparësi nga fillimi i vitit 2022, kur mbarojnë kontratat e para midis investitorëve dhe shtetit Shqiptar, dhe në vijim vit pas viti, do të jenë kapacitete të disponueshme për klientët e kualifikuar, me çmime edhe më të volitshme, se sa çmimet e bursës HUPX, pasi kjo sasi prodhohet në vend me kosto

më të ulëta dhe pa kosto transmetimi në linjat e interkoneksionit.

Një opsion tjetër i preferuar me kosto të ulët për sigurimin e energjisë elektrike nga klientët e kualifikuar është dhe investimi në panele diellore deri në 500 Kwp, pranë vendit të ushtrimit të aktivitetit. Sipas studimeve paraprake, deri në miratimin e një harte rrezatimi në varësi të pozicionit gjeografik, prodhimi nga panele diellore llogaritet 1.4 Mb/Kwp, ose në vlerë financiare nëse e llogarisim koston e furnizimit aktual të klientëve të kualifikuar prej 105 Eur/Mwh, do të prodhonte 147 Eur energji elektrike në vit, për Kwp.

Një impiant prej 500 Kwp, do të mund të prodhonte deri në 700 Mb energji, ose rreth 73.500 EUR energji elektrike në vit. Kostot e ndërtimit të paneleve diellore për Kwp sot variojnë midis 800 – 1800 EUR/Kwp, në varësi të cilësisë së paneleve, dhe volumit të projektit. Për rrjedhojë, investimi mund të shlyhet brenda 10-15 viteve, po ta llogarisim me vlerën e çmimit të rregulluar që furnizohen sot bizneset. Nëse kjo llogari do të bëhet me çmimet e bursës të HUPX sot, apo çmimeve të pritshme për vitet 2022-2023 që janë të parashikuara në vlerën e 180 Eur/Mw, ky investim mund të shlyhet brenda 6-10 viteve. Kohëzgjatja e paneleve llogaritet mbi 25 vjet pune, pa nevoja për mirëmbajtje të kushtueshme. Ky model investimi, rrit njëkohësisht sigurinë e furnizimit për klientin e kualifikuar dhe e ruan nga rritja e çmimeve në bursë, siç po ndodh aktualisht, kur energjia ka arritur në rreth 250 Eur/Mwh.

Për këto arsye, është koha që klientët e kualifikuar ta peshojnë me seriozitet marrjen e masave të nevojshme për sigurimin e energjisë elektrike nga furnizues të tregut të lirë, dhe ta prodhojnë vetë një pjesë të saj, pasi procesi i daljes së tyre në tregun e lirë tashmë është një realitet i përvitshëm./Bota.al



Grafiku Nr.1 (Çmimet Mesatare EUR për Mwh, sipas muajve për vitin 2021)


me Ligjin nr. 43/2015, e në vijim me akte të shumta ligjore e nënligjore, është parashikuar dalja me fasha në këtë sistem të klientëve të kualifikuar sipas nivelit të tensionit që ata janë të lidhur, deri në 0.4 Kv. Sipas kërkesave fillestare të ligjit, këta klientë duhet të kishin marrë statusin e klientit të kualifikuar jo më vonë se 31 Dhjetori i vitit 2017, por deri në 9 mujorin e vitit 2021, sipas Entit Rregullator të Energjisë Elektrike (ERE), klientët e Kualifikuar të lidhur në rrjetin e Shpërndarjes së Energjisë Elektrike, kanë konsumuar rreth 62.000 Mw, nga rreth 6.200.000 Mw, që është konsumi total në vend, bashkë me humbjet, pra rreth 0.01%.

Prej Janarit 2022, të shumtë janë bizneset të cilët kanë marrë njoftime shkresore nga OSHEE, për të siguruar një furnizues në tregun e lirë. Patjetër që koha që ky proces të ndodhë, sa vjen e bëhet më e shkurtër, dhe për bizneset më e prekshme. Të shumtat janë pyetje se çfarë kjo nënkupton për mënyrën se si ato

mesatar Eur/Mwh në dy javët e para të janarit 2022 ishte respektivisht 163 Eur/Mwh, java e parë dhe 250 Eur/Mwh, java e dytë. Të tilla diferenca volatile nuk janë aspak normale në tregun e energjisë elektrike, dhe madje mund të konsiderohen deri diku spekulative, pavarësisht një numri të lartë faktorësh objektivë, të cilët kanë përcaktuar këtë rritje shekullore. Ndërkohë tarifat zyrtare të miratuara nga ERE për klientët fundorë, përfshirë dhe tarifën e rrjetit janë përafërsisht 105 Eur/Mwh për bizneset dhe rreth 73 Eur/Mwh për klientët familjarë.

Kjo barrë e kësaj diference çmimi prej qershorit 2021 e në vijim mbahet nga shteti shqiptar, i cili ende nuk e ka rritur tarifën për konsumatorin dhe kjo është për t'u përgëzuar. Këtë ngarkesë financiare, shteti shqiptar sot e mban dhe për të gjithë ato biznese, që sipas ligjit do duhet të kishin statusin e “Klientit të Kualifikuar”, dhe ta siguronin vetë energjinë elektrike.

Të riktheheni tani të



EURO GLASS
SAINT-GOBAIN SEKURIT PILKINGTON
Enveri
Adr: Fushë Kosovë
Mob: 044 10 20 10 / 049 145 336
E-mail: euro.glass@live.com



**QENDRA SPORTIVE
'BUJOËSIA'
TEL: 045/82 82 82**

Pllana, pas prezantimit te Prishtina: Kjo fanellë ka peshë të madhe



PRISHTINË, 19 JANAR - Skuadra e Prishtinës është përforcuar me futbollistin Bujar Pllana. Mbrojtësi iu bashkua kampionëve në fuqi të Superligës. Pllana është 20-vjeçar dhe luan në qendër të mbrojtjes, si dhe mbrojtës i djathtë. Ai së fundmi ishte pjesë e Feronikelit, ekip me të cilin u nda javë më parë, pas një stinori shumë të mirë në aspektin individual. Bujari, që është zhvilluar si futbollist te Trepça '89, është pjesë edhe e Përfaqësueses së Kosovës U-21. Shtatlarti (1.87) është bashkuar me ekipin në fazën përgatitore në Antalia, me ç'rast e ka dhënë

një intervistë për faqen zyrtare të klubit. "Prishtina është klubi i madh dhe më me traditë në futbollin e Kosovës, andaj paraqitja në këtë fanellë është nder i madh. Nuk kam menduar shumë kur më erdhi oferta për t'iu bashkuar ekipit, sepse për mua do të thotë shumë që ta bart fanellën e Prishtinës, e cila për çdo lojtar është me peshë të madhe", ka thënë Pllana, i cili me pas foli edhe për synimet që ka me skuadrën kryeqytetase. Ai është optimist se do të arrijë të fitojë një vend në formacionin bazë. "Dua që t'u premtoj trajnerëve, bashkëlojtarëve, drejtuesve të klubit dhe tifozëve

se do ta japë më të mirën time që Prishtina t'i arrijë synimet e saj. Do të angazhohem maksimalisht që ta zë një vend në përbërjen bazë", ka deklaruar ai. "Në ekip më kanë pritur shumë mirë. Atmosfera në skuadrë është tejet pozitive dhe e kam gjetur një grup shumë të mirë. Tani në Antalia po punojmë dhe angazhohemi maksimalisht që për pranverë të jemi sa më të përgatitur", ka shtuar Pllana. Skuadra "bardhekaltër" sezonin vjeshtor e mbylli në vendin e pestë me 24 pikë të grumbulluara. Prej 18 ndeshjeve ka regjistruar 6 fitore, 6 barazime dhe po aq humbje.

SHKURT

Tjader Fernandez përforcon KB Peja

Klubi i Basketbollit Peja njofton se është përforcuar me basketbollistin nga Amerika Latine, Tjader Fernandez. "KB Peja njofton se ka nënshkruar me lojtarin e pozitës së organizatorit, Tjader Fernandez. Lojtari, i gjatë 1.78 cm, ka një përvojë në ligat e rëndësishme të Amerikës Latine dhe pritet të jetë ndihmesë e madhe për ekipin, pas lëndimit të Erdem Iler, i cili pritet të mungojë së paku tri javë. Mirë se vjen Tjader në folën e Shqiponjave!", thuhet në njoftimin e skuadrës pejane.

FIFA fton presidentin Ademi në Botërorin e klubeve

Federata Ndërkombëtare e Futbollit, FIFA, ka ftuar presidentin e Federatës së Futbollit të Kosovës, Agim Ademi, që të jetë mysafir special në Kampionatin Botëror të Klubeve që zhvillohet në Emiratet e Bashkuara Arabe nga data 3 deri më 12 shkurt. "Kjo ftesë është në vazhden e ftesave që presidenti Ademi ka marrë nga FIFA për ngjarje të rëndësishme ndërkombëtare, në të cilat nuk e kanë pasur rastin të jenë të gjithë presidentet e federatave anëtare të FIFA-së", thuhet në njoftimin e FFK-së.

Istogu arrin marrëveshje me mbrojtësin Rinor Kuqi

Skuadra e Istogut po vazhdon me përforcime. Ky klub e ka rikthyer mbrojtësin Rinor Kuqi i cili ka nënshkruar marrëveshje deri në qershor të këtij viti. Kuqi në sezonin vjeshtor ishte pjesë e skuadrës së Dukagjinit nga Klina dhe paraqitet e tij ishin të mira në BKT Superligën e Kosovës në futboll. "Football Club Istogu me kënaqësi njofton të gjithë opinionin sportiv, dashamirët dhe tifozët e Istogut, që klubi ka përmbyllur me sukses marrëveshjen me mbrojtësin Rinor Kuqi. Kuqi ka nënshkruar kontratë me Istogun deri më 30 qershor 2022. Rinori në sezonin e fundit ishte pjesë e Dukagjinit të Klinës, ku kishte paraqitje mjaft të mira në Superligën e Kosovës. Mbrojtësi 24-vjeçar do t'i ndihmojë mjaft shumë skuadrës së Istogut në fazën e mbrojtjes, ku mjaft mirë paraqitet në të gjitha pozitat e vijës së mbrojtjes", thuhet në njoftimin e skuadrës së Istogut.

Visar Musliu nënshkruan me FC Ingolstadt 04

FC Ingolstadt 04 ka nënshkruar me qendërmbrojtësin shqiptar Visar Musliu. Reprerentuesi i Maqedonisë së Veriut, i cili ka luajtur 40 ndeshje, ka kaluar në Gjermani nga hungareze e divizionit të parë MOL Fehervar FC. Të dy klubet kanë rënë dakord të mos i bëjnë të ditura shifrat e transferimit. Musliu është shprehur i lumtur që do të luajë në futbollin gjerman pas transferimit të tij. "Jam shumë i lumtur që kam nënshkruar për FC Ingolstadt 04. Është diçka shumë e veçantë të jesh në gjendje të luash në Gjermani, vendin ku luhet futboll. Përshtypjet e para për klubin dhe bisedimet me përgjegjësit ishin shumë pozitive. Tashmë mezi pres ta njoh skuadrën dhe dua të jap gjithçka në mënyrë që së bashku të përballojmë sfidën aktuale në mënyrën më të mirë të mundshme", ka deklaruar Musliu, i cili e ka filluar karrierën e tij profesionale në vitin 2011 me KF Renova në vendin e tij. Pas një huazimi në FK Gostivar në vitin 2012, ai u transferua në Zvicër te FC St. Gallen në vitin 2014. Një vit më vonë ai u kthye në atdhe, ku u largua për në Hungari në vitin 2019. Ai ka qenë pjesë edhe e Vardarit, FC Prishtinës dhe KF Shkëndijës.

Ilir Daja kompletin stafin teknik

SUHAREKË, 19 JANAR - Trajneri i FC Ballkanit, Ilir Daja, e ka kompletuar stafin teknik. Ndihmës të trajnerit Daja do të jenë Artim Pollozhani dhe Edon Gashi, kurse Alban Shala do të jetë trajner kondicional. Ndërsa

trajneri i portierëve është Labinot Qosa. "Klubi i Ballkanit njofton se është kompletuar stafi teknik, i cili ka marrë drejt objektive që ne kemi! Pasi u emërua në krye të stolit

Ilir Daja, klubi ju prezanton pjesëtarët e tjerë të stafit që kryetrajneri do të ketë në krah. Ndihmësit e trajnerit Ilir Daja do të jenë Artim Pollozhani dhe Edon Gashi teksa Alban Shala do të mbajnë pozicionin e

trajnerit kondicional. Portierët do të përgatiten nga trajneri Labinot Qosa. Klubi i Ballkanit i uron stafin teknik punë të mbarë dhe të suksesshme. Na priftë e mbara, Suharekë!", thuhet në njoftimin e Ballkanit.



Golden State shkëlqen ndaj Detroitit

SAN FRANCISCO, 19 JANAR - Dy ndeshje janë luajtur në NBA. Skuadra e Golden States fitoi me rezultat 102-86 ndaj Detroitit, duke qëndruar në

vendin e dytë në Konferencën e Perëndimit. Thompsoni me 21 pikë, Wigginsu me 19 e Curry me 18 pikë, bënë diferencën në

parket për Warriorsin. Fiton jashtë fushës edhe ekipi i Minnesotas, që mundi 112-110 New Yorku në sekondat e fundit, një ndeshje me

rivalitet. Për miqtë u dalluan Edwardsi me 21 pikë e Townsi me 20, duke i bërë 27 pikët e Fournier për vendasit.



Alvesi, i lutet Barçës: Rikthejeni Messin

BARCELONË, 19 JANAR - Dani Alves e ka shprehur dëshirën për të luajtur përsëri me Lionel Messin në Barcelonë, duke i bërë thirrje klubit katalonas ta kthejë argentinasi në "Camp Nou". Messi bëri nam si njëri nga futbollistët më të mirë në historinë e lojës gjatë qëndrimit 20-vjeçar në Barcelonë, para se të largohej verën e kaluar për t'iu bashkuar Paris Saint-Germainit. Sulmuesi argentinasi u largua nga "Camp Nou" sepse Barça nuk qe në gjendje t'ia vazhdonte marrëveshjen, për shkak të kufizimeve në paga të vendosura nga La Liga. 34-vjeçari, i cili fitoi tituj të shumtë në La Liga dhe në Ligën e Kampionëve në fanellën e Barçës, duke u bërë golashënuesi më i mirë në historinë e klubit, iu bashkua PSG-së por Alvesi beson se ai mund të bindet për t'u kthyer në Katalonjë pas vetëm një viti. Alvesi iu bashkua Barçës muajin e kaluar, duke u kthyer në klub pas pesë viteve e gjysmë por thotë se atmosfera prapa skenave nuk është e njëjta pa Messin. "Messi është lojtari më i mirë në historinë



e futbollit. Është e çuditshme të jesh këtu dhe të mos e shohësh atë, të mos e shohësh atë në skuadër", ka thënë Alves. "Nganjëherë gjërat nuk ndodhin siç ëndërrojmë ne. I kam thënë atij se në asnjë vend tjetër nuk do ta ketë më mirë se këtu. Ai më kishte thënë të njëjtën gjë kur u largova", ka shtuar ai. "Do të kishte qenë

shumë mirë nëse Messi e mbaron karrierën këtu. T'i japë fund karrierës këtu do të kishte qenë dhuratë e madhe për të dhe klubi mund ta rregullojë këtë punë", ka deklaruar Alves. Messi i shënoi 672 gola në 778 paraqitje për Barcelonën nga viti 2004 deri më 2021, duke i ndihmuar klubit t'i fitojë 35 trofe gjatë asaj kohe.

Mick Schumacher i 'shkel syrin' Mercedesit: Pa e provuar nuk e kupton dot sa i shpejtë je

VAUD, 19 JANAR - Mick Schumacheri përgatitet për sezonin e dytë në Formulën 1 me makinën amerikane Haas. Piloti i ri gjerman ka folur për dominimin e Mercedesit dhe faktit se me këtë makinë në vitet e fundit mund të kishte fituar kushdo. "Në Formula 1 të gjithë ata që pilotojnë e kanë merituar atë vend. Nuk mund të thuash se kushdo mund të fitojë me Mercedesin për sa kohë nuk je vetë brenda dhe nuk e provon. Nga jashtë nuk mund të japësh asnjë opinion konkret edhe pse Mercedes është makinë e shpejtë", ka thënë Mick Schumacher. Për sa i përket vitit 2022, ai shton: "Shpresoj



që të jemi më të shpejtë këtë vit dhe të duelojmë më shumë me rivalët.

Uroj që të kemi mundësi të hyjmë në zonën e pikëve".

SHKURT

Xavi 'kërcënon' Dembele: Rinovo ose të shitëm

Ousmane Dembele po kthehet në një çështje të madhe në shtëpinë e Barcelonës. Xavi nuk përdor lojërë fjalësh kur pyetet mbi situatën e sulmuesit francez. "Nuk mund të presim më shumë, o rinovon ose do të gjejmë një zgjidhje për ta shitur menjëherë. Nuk shoh alternativa të tjera. Më thotë që dëshiron të qëndrojë, por nuk firmos, këtë nuk e kuptoj këtë", u shpreh trajneri i Barcelonës. Dembele është futur në vitin që i skadon kontrata, në fund të sezonit mund të largohet falas.

Tucheli, pas barazimit ndaj Brightonit: Jemi të lodhur, na duhet pushim

Chelsea ka barazuar ndaj Brightonit për ta vazhduar formën e dobët që i ka lënë ata të dalin jashtë garës për titull. Thomas Tuchel e pranoi se nuk ka gëzim në Chelsea pasi skuadra dështoi të fitojë një ndeshje për herë të gjashtë në shtatë ndeshjet e fundit pas barazimit 1-1 ndaj Brightonit. Trajneri gjerman ka thënë se lojtarët e tij ishin të lodhur dhe të pakënaqur, pasi kishin nevojë për një pushim. Chelsea, dikur në garë për titull, tani është 12 pikë prapa Manchester Cityt me një ndeshje më shumë të luajtur. "[Edhe] në reagimin e golit [që ne e shënuam], mund të shihni se jemi të lodhur. Ishte të lehtësuar, por nuk kishte gëzim. Ne dukemi të lodhur dhe jemi... E shihni që jemi të lodhur mendërisht. Na duhen disa ditë pushimi, nuk ka zgjidhje tjetër", ka thënë Tucheli.

Messi kthehet në stërvitje

Lionel Messi u kthye në stërvitje me Paris Saint-Germain të martën për herë të parë që nga testimi pozitiv për Covid-19 në fund të vitit të kaluar. Sulmuesi argentinasi u pa duke u stërvitur me shokët e tij të PSG-së në një video të postuar nga klubi në "Twitter". Messi u infektua me virusin gjatë pushimeve në qytetin e tij të lindjes, Rosario në Argentinë. PSG-ja njoftoi më 5 janar se ai ishte kthyer në Francë pasi rezultoi negativ, por shtatë herë fituesi i Topit të Artë vetëm tani po ndihet mjaftueshëm në formë për të rifilluar stërvitjet normale. Messi ka shënuar vetëm një gol në 11 paraqitje në ligë për PSG-në, megjithatë ka shënuar pesë herë në Ligën e Kampionëve. Ai ka humbur gjithsej 10 ndeshje në Ligën 1 që nga gushti për shkak të lëndimeve, kthimit të vonuar nga detyra në Argentinë dhe më pas Covid-19, shkruan "news18". Messi mund të ftohet për ndeshjen ndaj Reimsit të dielën.

Hearn: Joshua dhe Fury do të përballen para fundit të vitit

Tifozët e boksit kanë gjasat maksimale që këtë vit të shohin duelin në mes të Anthony Joshuas dhe Tyson Furyt. Promotori i boksit (i Anthony Joshua), Eddie Hearn, ka shprehur optimizëm për një duel të mundshëm në mes të Joshuas dhe Furyt. Por, britaniku u ka premtuar tifozëve të boksit se do ta shohin duelin e gjigantëve britanikë këtë vit, më së voni në fillim të vitit tjetër. Hearn ishte shumë afër të caktonte një meç mes dyshes vitin e kaluar në Arabi, por nuk ia arriti dot. "Mendoj se Joshua - Fury është akoma meçi që presin të gjithë", ka thënë Hearn. "Dikush më pyeti sot se kur do të përballen AJ dhe Fury", ka shtuar ai. "Ky duel ju premtoj se do të ndodhë qoftë në fund të këtij viti, ose fillimvitin tjetër. Fury-Joshua duhet të ndodhë, sepse është meç shumë i madh për të mos ndodhur", ishin fjalët e promotorit. Fury pritet të kthehet në ring më 26 mars për duelin ndaj Whyte, kurse Joshua planifikon një rimeç me Usyk për muajin prill.

Newcasteli kërkon rikthimin e Balotellit në Premierë Ligë

Sheikët e Newcastle Unitedit duan të krijojnë një skuadër të madhe duke transferuar lojtarë të kalibrit të lartë në organikën e tyre. Sipas asaj që raporton britanikja "Daily Star", klubi bardhezi kërkon të rikthejë

në ishull sulmuesin italian i cili është duke bërë mjaft mirë në Turqi me fanellën e Adana Demirsporit. "Super Mario" do të ishte një nga objektivat e shumtë të pronësisë së re saudite, e cila dëshiron ta rikthejë klubin

në majat e futbollit britanik. Paraqitja e fundit në Premierë Ligë për ish-sulmuesin e Interit dhe Milanit ka qenë me fanellën e Liverpoolit shtatë vjet më parë në ndeshjen ndaj Hull Cityt më 28 prill 2015.

Rikthimi në një kampionat elitari siç është Premierë Liga do të ishte i rëndësishëm për Balotellin, i cili në mendjen e tij shpreson ende që ta bindë Roberto Mançinin që ta rikthejë në kombëtaren italiane për Botërorin e këtij

viti në Katar.

31-vjeçari me fanellën e Adana Demirsporit është aktivizuar në total në këtë sezon në Superligën e Turqisë në 18 ndeshje ku ka realizuar 7 gola dhe duke dhuruar dhe 2 asistime.



SHPALLJE E VENDIT TË LIRË TË PUNËS

Pozita:	Zyrtar i Licencimit
Departamenti:	Licencim dhe Standardizim
Divizioni:	Licencimit
Niveli i gradës:	6
Raporton tek:	Udhëheqësit të Divizionit të Licencimit/Drejtorit të DLS-së

Detyrat dhe përgjegjësitë e punës:

- Zbaton Manualin dhe Procedurat e Licencimit dhe të gjitha rregullat e brendshme të Departamentit;
- Kontribuon në shqyrtimin, vlerësimin dhe analizimin e të gjitha aplikacioneve për licencim, në pajtim me kornizën ligjore në fuqi;
- Shqyrton, vlerëson dhe analizon, në rastet më të komplekse në bashkëpunim me Udhëheqësin e Divizionit të Licencimit apo Drejtorin e DLS-së, të gjitha kërkesat e të institucioneve financiare, të cilat i delegohen, në pajtim me kornizën ligjore në fuqi;
- Kontribuon në analizimin e raporteve biografike dhe financiare të aksionarëve, drejtorëve dhe menaxhmentit të lartë të institucioneve financiare;
- Përgatit rekomandimet për aprovime/refuzime/revokime të kërkesave të deleguara drejtuar Udhëheqësit të Divizionit të Licencimit, Drejtorit të DLS-së dhe Bordit Ekzekutiv;
- Shqyrton të gjitha kërkesat për hapje, zhvendosje dhe mbyllje të degëve dhe zyrave të institucioneve financiare;
- Kontribuon në shqyrtimin e të gjitha kërkesave për licencim/regjistrim të agjentëve/brokerave të institucioneve financiare;
- Kryen ekzaminimet e para hapjes në degët/zyrat e institucioneve financiare;
- Mirëmban dosjet fizike dhe elektronike të institucioneve financiare duke përfshirë regjistrat për personat kyç (aksionarët, drejtorët dhe menaxherët e lartë), zyrat e institucioneve financiare, agjentët dhe brokerat e institucioneve financiare;
- Kontribuon në draftimin e politikave, procedurave, manualeve të licencimit, rregulloreve, rregullave dhe udhëzimeve tjera të institucioneve financiare, të deleguara;
- Mbështet bashkëpunimin e nevojshëm me të gjitha palët relevante të Departamentit;
- Kryen të gjitha detyrat tjera të cilat i caktohen nga Udhëheqësi i Divizioni i Licencimit dhe Drejtori i DLS-së.

Kualifikimet dhe përvoja e kërkuar:

- Diplomë bachelor në drejtimin; ekonomi, financa dhe kontabilitet;
- Të ketë provojë punë tre (3) vite në financa, kontabilitet, apo në industrinë e sigurimeve.
- Rrjedhshmëri në gjuhën shqipe dhe/ose serbe;
- Njohje e gjuhës angleze e preferuar.

Të gjithë kandidatët duhet të dërgojnë dokumentet e mëposhtme:

- Formularin zyrtar të BQK-së për aplikim;
- Letrën përcjellëse (motivuese) ku theksohet interesimi për këtë pozitë;
- Kopjet e diplomave, ndërsa diplomat e fituara jashtë Republikës së Kosovës duhet të jenë të njohura /nostrifikuara zyrtarisht nga ana e MASHT-it;
- Dëshmi mbi përvojën e punës të lëshuar nga institucioni/organizata kompetente e mbështetur me dëshmi nga Trust;
- Dëshmi mbi identitetin dhe vendbanimin e përhershëm në Kosovë;

Procedura e aplikimit:

- Afati i fundit për aplikim është **03 shkurt 2022**.
- Aplikimi mund të bëhet online (<https://hris.bqk-kos.org>) përmes faqes zyrtare të BQK-së ose përmes arkivit të BQK-së. Asnjë formë tjetër e aplikimit nuk do të merret parasysh.
- Formën e aplikacionit mund ta shkarkoni përmes faqes zyrtare : www.bqk-kos.org
- **Dokumentacionet e pakompletuara nuk do të merren parasysh. Vetëm kandidatët të cilët i plotësojnë kriteret e konkursit do të kontaktohen.**



OGLAS ZA SLOBODNO RADNO MESTO

Pozicija:	Službenik za licenciranje
Odeljenje:	Licenciranje i standardizacija
Divizija:	Licenciranje
Stepen:	6
Izveštava kod:	Rukovodioca Divizije za licenciranje/Direktoru OLS-a

Radne dužnosti i odgovornosti:

- Primenjuje Priručnike i procedure licenciranja i sva interna pravila Odeljenja;
- Doprinosi razmatranju, proceni i analizi svih prijava za licenciranje, u skladu sa važećim zakonskim okvirom;
- Razmatra, procenjuje i analizira, u najsloženijim slučajevima u saradnji sa rukovodiocem Divizije za licenciranje ili direktorom OLS-a, sve zahteve finansijskih institucija, koje se njemu delegiraju, u skladu sa važećim zakonskim okvirom;
- Doprinosi analiziranju biografskih i finansijskih izveštaja akcionara, direktora i višeg rukovodstva finansijskih institucija;
- Priprema preporuke za odobravanje/odbijanje/povlačenje zahteva delegiranih rukovodiocu Divizije za licenciranje, direktoru OLS-a i Izvršnom odboru;
- Razmatra sve zahteve za otvaranje, premeštanje i zatvaranje filijala i kancelarija finansijskih institucija;
- Razmatra sve zahteve za licenciranje/registraciju agenata/brokera finansijskih institucija;
- Vršiti ispitivanja proširenja filijala/kancelarija finansijskih institucija;
- Održava štampane i elektronske dosjee finansijskih institucija, uključujući registre ključnih lica (akcionari, direktori i viši rukovodioci), kancelarije finansijskih institucija, agente i brokere finansijskih institucija;
- Doprinosi izradi politika, procedura, priručnika za licenciranje, ostalih delegiranih propisa i uputstava finansijskih institucija;
- Podržava neophodnu saradnju sa svim relevantnim stranama Odeljenja;
- Obavlja sve druge obaveze koje su mu određene od strane rukovodioca Divizije za licenciranje i direktora OLS-a.

Potrebne kvalifikacije i iskustvo:

- Bačelor diplomu u smeru ekonomije, finansija i računovodstva;
- Da ima tri (3) godine radnog iskustva u oblasti finansija, računovodstva ili u industriji osiguranja.
- Tečno poznavanje albanskog i/ili srpskog jezika;
- Poželjno je znanje engleskog jezika.

Svi kandidati treba da dostave dole navedena dokumenta:

- Zvaničan obrazac CBK za apliciranje;
- Prateće (motivaciono) pismo gde se naglašava zainteresovanost za ovu poziciju;
- Kopije diploma, dok diplome stečene izvan Republike Kosovo moraju biti zvanično priznate/nostrifikovane od strane MONT-a;
- Dokaz o radnom iskustvu izdat od nadležne institucije/organizacije podržan dokazima iz Trust-a;
- Dokaz o identitetu i stalnom prebivalištu na Kosovu.

Procedura za apliciranje:

- Poslednji rok za apliciranje je **03. februar 2022**.
- Apliciranje se može izvršiti online (<https://hris.bqk-kos.org>) preko službene internet stranice CBK -a ili putem arhive CBK -a. Nijedan drugi oblik apliciranja neće se razmatrati.
- Obrazac za apliciranje možete preuzeti putem službene internet stranice: www.bqk-kos.org
- **Nepotpuna dokumentacija se neće razmatrati. Biće kontaktirani samo kandidati koji ispunjavaju uslove konkursa.**



SHPALLJE E VENDIT TË LIRË TË PUNËS

Pozita: Mbikëqyrës i Ri Bankar (një)
Departamenti/Divizioni: Departamenti i Mbikëqyrjes Bankare
Niveli i gradës: 7
I raporton: Udhëheqësit të Divizionit
Numri i vartësve, nëse ka: Jo e aplikueshme
Detyrat dhe përgjegjësit:

- Përgjegjës për ekzaminimin në vend të bankave;
- Ndihmon mbikëqyrësin përgjegjës në planifikimin e ekzaminimeve në vend të bankave, në shqyrtimin e raporteve dhe vlerësimeve nga divizioni i raportimit dhe analizave, përcaktimin e fushëveprimit, planifikimin e resurseve dhe kohës së ekzaminimeve në vend të bankave;
- Ndihmon ekipin e mbikëqyrësve gjatë ekzaminimeve në vend në banka;
- Ndihmon mbikëqyrësit në vlerësimin e fushave të përgjegjësive të caktuara nga mbikëqyrësit përgjegjës, gjatë ekzaminimeve në banka;
- Ndihmon / përpilon raportet vlerësuese dhe analizat periodike të performancës financiare të bankave, IMF-ve dhe IFJB-ve, konform qasjes së mbikëqyrjes së bazuar në rrezik;
- Ndihmon në monitorimin për së afërmi performancën financiare të bankave, IMF-ve dhe IFJB-ve;
- Ndihmon në monitorimin e indikatorëve të sistemit të paralajmërimit të hershëm dhe në përgatitjen e raporteve vlerësuese lidhur me këta indikatorë;
- Kryen detyra tjera të caktuara nga udhëheqësi i divizionit;

Kualifikimet e kërkuara:

- Të ketë të kryer fakultetin ekonomik, financa, kontabilitet, matematikë, ose inxhinieri;
- Preferohet të ketë diplomë në fushën e kontabilitetit në ndonjë institucion të licencuar;
- Njohuri të mira teknike, të nevojshme për analiza dhe të kuptuarit e funksionit të auditimit dhe kontrolleve të brendshme;
- Njohuri bazike të standardeve ndërkombëtare të raportimit financiar;
- Të ketë njohuri të mira rreth operacioneve të institucioneve financiare, të nevojshme për vlerësimin e përshtatshmërisë së politikave, procedurave dhe sistemeve operative të bankave;
- Njohuri të mira për kuadrin ligjor, rregulloret dhe standardet aplikative të zbatueshme ndaj bankave për të vlerësuar përshtatshmërinë e tyre;
- Njohuri të vlerësimit dhe përdorimit të aplikacioneve të nevojshme kompjuterike;
- Përpikëri në respektimin e afateve për punët dhe angazhimet e caktuara nga mbikëqyrësi;
- Aftësi të mira për vlerësime dhe vendimmarrje nën mbikëqyrje minimale nga mbikëqyrësit;
- Demonstrim aftësi të mira të komunikimit gojor, komunikimit me shkrim, të dëgjimit dhe prezantimit tek mbikëqyrësit, mbikëqyrësit dhe palët tjera;
- Aftësi për të punuar në mënyrë efektive në ekip; aftësi në menaxhimin e kohës lidhur me kompletimin dhe cilësinë e detyrave të punës; aftësi për të punuar në mënyrë efektive me mbikëqyrësin dhe ekipin; aftësi të punuarit, diskutimit dhe bindjes me palët e jashtme.

Njohja e gjuhëve të huaja:

- Preferohet të ketë njohuri të gjuhës angleze;

Të gjithë kandidatët duhet të dërgojnë dokumentet e mëposhtme:

- Formularin zyrtar të BQK-së për aplikim;
- Letrën përcjellëse (motivuese) ku theksohet interesimi për këtë pozitë;
- Kopjet e diplomave, ndërsa diplomat e fituara jashtë Republikës së Kosovës duhet të jenë të njohura /nostrifikuara zyrtarisht nga ana e MASHT-it;
- Dëshmi mbi identitetin dhe vendbanimin e përhershëm në Kosovë;

Procedura e aplikimit:

- Afati i fundit për aplikim është **03 shkurt 2022**.
- Aplikimi mund të bëhet online (<https://hris.bqk-kos.org>) përmes faqes zyrtare të BQK-së ose përmes arkivit të BQK-së. Asnjë formë tjetër e aplikimit nuk do të merret parasysh.
- Formën e aplikacionit mund ta shkarkoni përmes faqes zyrtare: www.bqk-kos.org
- Dokumentacionet e pakompletuara nuk do të merren parasysh. Vetëm kandidatët të cilët i plotësojnë kriteret e konkursit do të kontaktohen.



OGLAS ZA SLOBODNO RADNO MESTO

Pozicija: Mladi bankarski nadzornik (jedan)
Odeljenje/Odsek: Odeljenje bankarskog nadzora
Nivo stepena: 7
Izveštava: Rukovodiocu Odseka
Broj podređenih, ako ima: Nije sprovodljivo

Dužnosti i odgovornosti:

- Odgovoran za kontrolu banaka na licu mesta;
- Pomaže nadležnom nadzorniku u planiranju kontrole banaka na licu mesta, mikrofinansijских institucija i nebankarskih finansijских institucija u razmatranju izveštaja i procena od strane odseka za izveštavanje i analizu, određivanju delokruga, planiranju resursa i vremena kontrola na licu mesta;
- Pomaže nadzornom timu tokom kontrola na licu mesta u bankama;
- Pomaže nadzornicima u proceni oblasti odgovornosti koje su im odredili nadležni nadzornici, tokom kontrola u bankama;
- Pomaže/izrađuje izveštaje o proceni i periodične analize finansijского učinka banaka, MFI i NBFI, u skladu sa pristupom nadzora zasnovanom na riziku;
- Pomaže u pomnom praćenu finansijского učinka banaka, MFI i NBFI;
- Pomaže u praćenju pokazatelja sistema ranog upozoravanja i priprema izveštaje o proceni koji se odnose na ove pokazatelje;
- Vršiti i druge zadatke koje mu odredi rukovodilac odseka;

Potrebne kvalifikacije:

- Da ima završen ekonomski fakultet, finansije, računovodstvo, matematiku ili inženjerstvo;
- Poželjno je imati diplomu iz oblasti računovodstva u nekoj licenciranoj instituciji;
- Dobro tehničko znanje, neophodno za analizu i razumevanje funkcije revizije i unutrašnjih kontrola;
- Osnovno poznavanje međunarodnih standarda finansijского izveštavanja;
- Da dobro poznaje operacije finansijских institucija, potrebne za procenu adekvatnosti politika, procedura i operativnih sistema banaka;
- Dobro poznavanje pravnog okvira, uredbi i sprovodljive standarde koji se sprovode na banke radi procene njihove usklađenosti;
- Poznavanje procene i korišćenja neophodnih računarskih aplikacija;
- Preciznost u poštovanju rokova za zadatke i angazovanja koje je odredio nadzornik;
- Dobre veštine procene i donošenja odluka pod minimalnim nadzorom nadzornika;
- Da pokaže dobru usmenu komunikaciju, pismenu komunikaciju, slušanje i prezentaciju nadzorniku, nadzornicima i drugim stranama;
- Sposobnost efektivnog rada u timu; sposobnost upravljanja vremenom vezane za završetak i kvalitet radnih zadataka; sposobnost efektivnog rada sa nadzornikom i timom; sposobnost rada, diskusije i ubeđivanja sa spoljnim stranama.

Poznavanje stranih jezika:

- Poželjno je znanje engleskog jezika;

Svi kandidati treba da dostave sledeća dokumenta:

- Službeni obrazac CBK-a za apliciranje;
- Prateće (motivaciono) pismo gde je naglašen interes za ovu poziciju;
- Kopije diploma, dok diplome stečene van Republike Kosovo moraju biti zvanično priznate/nostrifikovane od strane MONT-a;
- Dokaz o identitetu i stalnom prebivalištu na Kosovu;

Procedura apliciranja:

- Zadnji rok za apliciranje je **3. februar 2022**.
- Apliciranje se može izvršiti online (<https://hris.bqk-kos.org>) preko službene internet stranice CBK-a ili putem arhive CBK-a. Nijedan drugi oblik apliciranja neće se razmatrati.
- Obrazac za apliciranje možete preuzeti putem službene internet stranice: www.bqk-kos.org
- Nepotpuna dokumentacija se neće razmatrati. Biće kontaktirani samo kandidati koji ispunjavaju uslove konkursa.



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Kuvendi i Republikës së Kosovës, në bazë të nenit 10, paragrafi 2 të Ligjit nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, shpall:

KONKURS

Për zgjedhjen e dy (2) anëtarëve të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, nga komunitetet joshqiptare

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës (Këshilli) është organ i pavarur që i raporton Kuvendit të Republikës së Kosovës dhe i cili vendos për ankesat e nëpunësve, si dhe siguron respektimin e rregullave dhe parimeve që rregullojnë shërbimin civil.

Përbërja e Këshillit

Këshilli përbëhet prej shtatë (7) anëtarëve që zgjedhën nga Kuvendi i Republikës së Kosovës.

Prej tyre, së paku dy (2) anëtar zgjedhën nga komunitetet joshqiptare dhe së paku dy (2) anëtar duhet të jenë të gjinisë femërore.

Funksionet e Këshillit:

- Mbikëqyr zbatimin e rregullave dhe parimeve të legjislacionit për shërbimin civil;
- Shqyrton dhe merr vendime për ankesat e nëpunësve civil dhe kandidatëve për praninë në shërbimin civil;
- Mbikëqyrë procedurën e përzgjedhjes dhe vendos nëse emërimet e nëpunësve civil të nivelit të lartë drejtues dhe të nivelit drejtues, janë zhvilluar në pajtim me rregullat dhe parimet e legjislacionit për shërbimin civil;
- Monitoron institucionet e administratës publike që kanë të punësuar nëpunës civil, lidhur me zbatimin e rregullave dhe parimeve të legjislacionit për shërbimin civil.

